



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Nr. 0-11
Prishtinë, më 10.6. 2008, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione

Morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Munguan: Z. Naim Rrustemi, që ishte në një udhëtim zyrtar.

Kryetari ia propozoi Komisionit këtë

REND DITE

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
- 2 Shqyrtimi i disa peticioneve
- 3 Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

U hap diskutimi për pikën e parë.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i disa peticioneve

Ismet Beqiri – I përshëndeti anëtarët dhe i falënderoi për pjesëmarrje në mbledhje dhe i njoftoi lidhur me pikën e rendit të ditës për të cilën do të debatohet dhe e ftoi raportuesen ta merrte fjalën.

Prof dr. Nrxhivane Dauti – Në cilësi të raportueses të peticioneve theksoi se po bëhet një punë e madhe me shqyrtimin e peticioneve nga legjislatura e kaluar. Pa humbur kohë filloi t'i njoftonte anëtarët për përmbajtjen e tyre, por edhe për rekomandimin për zgjidhjen e tyre.

Komisionin e informoi raportuesja lidhur me shkresën nr. 02-3627 të datës 11. 5. 2008, të ushtruar nga Zeqir Osmani nga Vushtria, në të cilën kërkohet që ndërmarrja private “Nevko - Llamkos – Steell” t’ia paguajë kompensimin prej 22. 7. 2005 deri më 2008. Ajo lidhur me këtë sugjeron t’i drejtohet pala gjykatës kompetente për realizimin e së drejtës, pasi kjo nuk është në kompetencë të Komisionit. Me propozimin e saj u pajtua Komisioni.

Komisioni sugjeroi që palës t’i përcillet rekomandimi.

- Komisionin e njoftoi raportuesja me shkresën nr. 02-3628, të datës 3. 8. 2007, nga të burgosurit e Burgut të Dubravës me nënshkrime të palexueshme. Në të ata i shfaqin opinionet e tyre lidhur me gjyqtarët e korrumpuar. Raportuesja vuri në pah se kjo çështje nuk është në kompetencë të Komisionit dhe rekomandoi që shkresa t’i përcillet Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni u pajtua me propozimin e raportueses.

- Raportuesja njoftoi për shkresën e BL Lisockë, nr. 02-3674, të 22. 8. 2007, me të cilën kërkohet të ndihmohet rregullimi i rrugës që i lidh fshatrat Lisockë dhe Hogosht. Gjithashtu kërkohet të ndërmerren veprime për përforcimin e transmetuesit të Valës 900. Ajo rekomandoi që shkresa t’i dërgohet Ministrisë së Transportit dhe Posttelekomit.

Komisioni e mirëpriti propozimin e raportueses dhe u pajtua që shkresa t’i dërgohet ministrisë përkatëse.

- Raportuesja e njoftoi Komisionin për peticionin nr. 02-3684, të datës 23. 8. 2007, të RTP-së, që ka të bëjë me të drejtat institucionale për kthimin e punonjësve të RTP-së në objektet e veta të punës që janë marrë me dhunë më 1990 dhe nuk janë kthyer deri më tani. Raportuesja, duke e parë rëndësinë e këtij peticioni, i propozoi Komisionit të mbahet dëgjim publik në të cilin do të ftohen aktorët dhe mjetet e informimit. Lidhur me këtë u zhvillua debat.

Ibrahim Makolli – Duke u ndërlidhur me propozimin e raportueses shtoi se RTP-ja ka arsye t’i kërkojë të drejtat e veta, sepse RTK-ja është trashëgimtare e saj dhe se punonjësit e saj i mbron ligji.

Sanije Alijaj – Duke u ndërlidhur me parafolësin kërkoi nga RTK-ja t’i respektojë ligjet.

Hajredin Hyseni – Ishte i mendimit të ftohej RTK-ja në dëgjimin publik, meqenëse edhe ajo e ka një version tjetër.

Drita Maliqi - Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve lidhur me mbajtjen e dëgjimit publik me pjesëmarrjen e RTK-së, por nëse nuk është respektuar ligji, kjo çështje duhet të ngrihet dhe punëtorëve t’u ofrojmë mbështetje.

Komisioni lidhur me këtë pikë e nxori këtë

P e r f u n d i m

Komisioni u pajtua të organizohet dëgjim publik lidhur me peticionin e RTP-së dhe të ftohen aktorët dhe mjetet e informimit. Koha e mbajtjes do të caktohet më vonë.

- Raportuesja e njoftoi Komisionin për përmbajtjen e peticionit nr. 02-3717, të datës 30. 8. 2007, ku jepen fakte lidhur me disa vepra penale që kanë të bëjnë me çështjen e personave të pagjetur dhe konsiderohet se dëgjimi do të kontribuonte në zbardhjen e fatit të tyre. Raportuesja i propozoi Komisionit të mbahet dëgjimi.

Komisioni e mirëpriti propozimin dhe e nxori këtë këtë

P e r f u n d i m

Komisioni vendosi që më 24.6.2008 të organizojë takim të përbashkët lidhur me shqyrtimin e peticionit të avokatit Tomë V. Gashi, përfaqësues juridik i së dëmtuarës Lutfije Behrami. Në këtë takim u vendos të ftohen: z. Tomë Gashi, kryeprokurori i Kosovës, Ministria e Drejtësisë dhe Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur.

3. Të ndryshme

Ismet Beqiri – I njoftoi anëtarët për takimin që kishte zhvilluar me Delegacionin e grave nga Republika e Shqipërisë, të organizuar nga NDI-a. Takimin e vlerësoi lart, sepse u shkëmbyen përvojat ndërmjet shteteve vëllazërore.

Ibrahim Makolli – Kërkoi nga Komisioni të marrë nismë për hartimin e Projektligjit për personat e pagjetur. Shtoi se lidhur me hartimin e tij Komisioni ka ekspertë të mjaftueshëm.

Sanije Alijaj – I propozoi Komisionit të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës të lejohet një vizite pune ne Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të dy komisionet homologe t’i shkëmbejnë përvojat.

Drita Maliqi – E ripërsëriti kërkesën të vizitohet Krusha e Madhe dhe për së afërmi të njoftohen familjet që kanë persona të pagjetur.

Komisioni e mirëpriti propozimin dhe u pajtua që kjo vizitë të bëhet më 26. 6. 2008, në orën 10:00. .

Luljeta Shehu – duke u ndërlidhur lidhur me vizitën kërkoi paraprakisht te behet përgatitje me shkrim

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30

Procesverbalin e hartoi

Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri